Mirëpo bazuar në informatat dhe hulumtimet e bëra paraprakisht në qeverisjen komunale të Deçanit sipas znj. Idrizaj, pothuajse në të gjitha rastet, kuota gjinore është shpërfillur dhe nuk ka shënja të ngritjes së ndonjë përqindje të pritur.

"Bazuar në këto fakte aq të rëndësishmë të mos përfshirjes së gruas në ekzekutivin komunal, gruaja pothuajse ka mbetur e pafuqishme dhe më të drejta të pakëta, kur dihet se nga 11 drejtoratet, tri prej të cilave u formuan pa marrë vizen finale të Asamblesë komunale, vëtëm nje pozitë ekzekutive u nda për gratë. Poashtu në institucionin e arsimit, shëndetësisë, atë të sigurise publike edhe në shumë institucione tjera të nivelit komunal, përfaqësimi gjinor është i pakët dhe mungon gruaja në vendimmarrje" thotë ajo. Evidente është edhe mungesa e përfaqësimit të grave në Komitetet më më rëndësi të asamblesë komunale, siç është ai për politikë dhe financa, ku gruaja mbetet jashtë çdo informate rreth planifikimit të buxhetit të komunës. " Përderisa nuk kemi gra kryetare të Komunës, Kryetare të Asmablesë, gra në Drejtorate, në Komitete obligative dhe Borde të rëndësishmë, ne nuk mund të themi se kemi një trajtim adekuat edhe të çështjeve që lidhen me mirëqenien e gruas, familjes dhe shoqërisë në përgjithësi" ka thënë Këshilltarja Valbona Idrizaj.

E drejta e gruas që të jetë pjesë e barabartë e shoqërisë sonë është e garantuar me ligj, këto ligje janë miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe janë thëlbesore për një përfshirje aktive të gruas në jetën institucionale, politike, publike dhe socio-ekonomike ka potencuar ajo duke shtuar se në qeverisjen lokale të komunës mungon plotësisht përkrahja e gruas në biznes e veqanërisht e grave kryefamiljare. " Ekzekutivi komunal nuk ka zhvilluar politika të cilat e fuqizojnë ekonomikisht gruan, sidomos kur kemi parasysh se mbi 60% e të papunëve në komunën tonë e përbëjnë gratë" thotë znj. Idrizaj.

Duke pas parasysh se ligjet për barazi gjinore dhe ligjet tjera në fuqi të cilat avancojnë rolin e gruas në qeverisjen komunale, zbatohen shumë pak ose fare, Idrizaj konsideron se trajnimet e organizuara dhe përvoja e bashkëpunimit me OJQ Zana ishte një ndihmesë që si Asambleistë të punohet më shumë në promovimin dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së gruas në pozita vendimmarrëse në komunë.
Mendoj që me një angazhim gjithëpërfshirës, si Asamble, si Komunë, si shoqëri dhe si qytetarë të komunës mundë të ndikojmë që të krijohet një mundësi e barabartë për të gjithë, pa dallim, tha ajo. "Lë të jetë ky një rast i mirë, që të mendojmë që, secila grua dhe secili burrë ta ketë hisen e vet, me përbërje të barabartë në të gjitha proceset e vendimmarrjes. Këtë e garanton Kushtetuta e vendit, këte e garantojnë Ligjet në fuqi, këtë e garantojnë Rregulloret që promovojnë pjesëmarrjen e barbartë, këtë e garanton edhe Ligji për Barazi Gjinore dhe të gjithë mekanizmat tjerë institucional që promovojnë pjesmarrjen e barabartë të gruas në pozitat e vendimmarrjes" ka vlerësuar Valbona Idrizaj, Këshilltare e Asambles komunale të Deçanit nga Lidhja Demokratike e Kosovës.



## BLERTA MALIQAJ

Klinë
Subjekti politik: PDK
Shkollimi: Kandidate e Magjistraturës në gazetari dhe kontakte me publikun

Duke ditur se Legjislacioni në Kosovë ofron një bazë të mirë për inkurajimin dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së femrës në procesin e punës dhe vendimmarrjes, Grupi i Grave Asambleiste të Klinës i themeluar me 05 Dhjetor te vitit 2011, vendosi t'i drejtohet opinionit publik përmes kësaj konference ,lidhur me pozitën e femrës ne proceset vendim - marrëse në komunën tone .

Prandaj edhe qëllimi i kësaj konference është promovimi dhe fuqizimi i pjesëmarrjes së gruas në pozita vendimmarrëse në komunën tonë.

Personalisht nuk jam këtu të përfaqësoj dhe mbroj ide feministe, por të promovoj vlera demokratike dhe barazi njerëzore për të gjithë, pa dallim, gjinie, feje, race a kombësie.

Pjesëmarrja e femrave dhe veçanërisht atyre që janë të reja në moshë në procesin e punës dhe vendimmarrjes në komunën tonë, është shumë e kufizuar dhe nuk është proporcionale me përqindjen gjinore të popullsisë, pavarësisht se Ligji për Barazinë Gjinore e parasheh që pjesëmarrja e barabartë gjinore në institucione është arritur vetëm atëherë kur përfaqësimi në nivel të pushtetit është 40 %. Mirëpo bazuar në informatat dhe hulumtimet pothuajse në të gjitha rastet, kuota gjinore është shpërfillur dhe nuk ka shenja të ngritjes së ndonjë përqindje të pritur.

Bazuar në këto fakte, kjo shtresë e shoqërisë pothuajse ka mbetur pa zë dhe me të drejta të pakta, kur dihet se nga 10 drejtoratet, asnjë nuk udhëhiqet nga femrat.

Nga 136 zyrtarë të Administratës komunale, vetëm rreth 28 janë gra edhe ato jo në pozita të vendimmarrjes. Po ashtu ne institucionet si: arsimi, shëndetësia, siguria publike, në polici por edhe në shumë institucione tjera të nivelit komunal, mungon vendimmarrja e femrës. Në këtë rast, evidente është edhe mungesa e përfaqësimit të grave në komitetin më të rëndësishëm të Asamblesë Komunale, siç është ai për Politikë dhe Financa, ku femrat mbetet jashtë çdo informate rreth planifikimit të buxhetit të komunës sonë.

Poashtu mund të theksoj se mungon plotësisht përkrahja e femrave në biznese e veçanërisht e atyre kryefamiljare, për të cilat ekzekutivi komunal nuk ka zhvilluar politika të cilat e fuqizojnë ekonomikisht gruan, sidomos kur kemi parasysh se mbi 60% e të papunëve në komunën tonë e përbëjnë gratë.

Nuk të mund të konsiderojmë se kemi një trajtim adekuat të çështjeve që lidhen me mirëqenien e gruas, familjes dhe shoqërisë në përgjithësi, kur dihet se në të gjitha drejtoratet kemi të emëruar udhëheqës meshkuj, Asambleja Komunale udhëhiqet nga një mashkull, nënkryetari i Komunës është mashkull, e shumë pozita të tjera udhëheqëse janë meshkuj, siç janë shkollat, Shtëpia e Shëndetit, e institucione të tjera.

E drejta e gruas që të jetë pjesë e barabartë e shoqërisë sonë është e garantuar me Kushtetutë dhe ligje. Këto ligje janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, prandaj duhet respektuar.

Në këto rrethana, kërkoj përkrahjen e të gjithëve si të femrave ashtu edhe të meshkujve, në mënyrë që të ndalohet diskriminimi i atyre femrave që janë viktima të rrethanave të pabarazisë gjinore, diskriminimit, kushteve jo të mjaftueshme për një arsimim, punësim dhe emancipim adekuat, si një e drejtë elementare për jetesë.

Një parim i tillë është me tej i garantuar veç tjerash edhe me Ligjin Kundër Diskriminimit i cili është kundër diskriminimit në baza gjinore, i përcaktuar me nenin 2 në këtë ligj. Fusha e zbatimit të këtij ligji mbulon jo vetëm institucionet publike, por edhe ato private duke përfshirë veprimet dhe mosveprimet edhe të personave fizik të cilat parashihen me Nenin 4 të këtij ligji.

Dhe për fund t'ua kujtoj edhe njëherë se barazia mes njerëzve është themel i demokracisë, andaj t'i mbrojmë dhe promovojmë vlerat demokratike në të cilat thirremi çdo ditë.

ZANA
Adresa: Abedin Rexha,pa nr, 32000 Klinë-Kosovë | Tel:377 44 406 812 039 470 249
Email:shg_zana@hotmail.com, info@ngo-zana.org | Web:www.ngo-zana.org



Organizata Joqeveritare
Non Governmental Organization
ZANA

Buletini nr. 1 | Maj 2012 | Klinë

Të nderuar-a lexuese dhe lexues,

Mirë së vini në Buletinin e parë, i cili shtypet në kuader të projektit **"Avokimi dhe ngritja e kapaciteteve për gratë vendimmarrëse në Rajonin e Pejës"**, Projekti ka për qëllim të ndërtoj kapacitete dhe të avokoj për implementimin e mekanizmave institucional për pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse, përmes trajnimeve në barazin gjinore, lobim dhe ngritje të spikatjes së grave në politikë.

## Roli i gruas në procesin e vendimmarrjes

Roli i gruas në procesin e vendimmarrjes paraqet një nga sfidat kryesore në shoqërinë kosovare. Edhe pse pjesëmarrja e femrës në institucionet e Kosovës është e përcaktuar me ligj, madje e siguruar përmes kuotave, kyçja e tyre në proceset vendimmarrëse është ende shumë e kufizuar.Në Republikën e Kosovës janë nxjerrë një varg ligjesh dhe politika të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së femrave dhe meshkujve në shoqëri dhe mënjanimit të pabarazisë gjinore ekzistuese. Pikë së pari, kemi kushtetutën e cila në Nenin 7.2. përcakton se

*"Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore".*



Më tej, kemi ligjin për barazi gjinore i miratuar në vitin 2004, me të cilin mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Përveç këtyre dy akteve bazë për trajtimin e barazisë gjinore, kemi edhe ligje dhe dokumente ndërkombëtare të cilat trajtojnë më hollësisht promovimin e barazisë gjinore. Ndër to mund të përmendim, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), Rezolutën 1325 të Kombeve të Bashkuara, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (objektivi 3), Ligjin kundër Diskriminimit, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht neni 27.1 i cili sanksionon se: *"në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik, së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra..."*, etj.

***Barazi gjinore** do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi ( Ligji për barazi gjinore)*

Përgjithësisht, mund të themi se korniza ligjore edhe në bazë të vlerësimeve që janë dhënë nga raportet e organizatave joqeveritare, si ato lokale ashtu edhe ato rajonale e ndërkombëtare, është një ndër më të arrirat në rajon për promovimin e barazisë gjinore dhe ofrimin e kushteve të barabarta mes meshkujve dhe femrave në çdo fushë, si atë politike, ekonomike, kulturore e sociale. Arritje ndër të cilat mund të përmenden përgjatë funksionalizimit të përpjekjeve për arritjen e barazisë gjinore është edhe vendosja e kuotave e cila ka arritur të rrisë pjesëmarrjen e grave në institucionet qendrore dhe lokale në një nivel më të kënaqshëm.
Në nivelin e pozitave vendimmarrëse, një prej arritjeve më të mëdha drejtë avancimit të pozitës së femrës në Kosovë është zgjedhja e Atifete Jahjagës si femra e parë presidente e Kosovës e njëherësh presidentja e parë në Evropën Juglindore.

Buletini apo letra iformuese shtypet në kuadër të këtij projekti që po e implementon OJQ "Zana" në Klinë. "Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu jane te Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojne qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

